

*Të propozuar
16.09.2018 në datë 16.09.18*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Tirane më 4.7.2018

PROPOZIME PËR AMENDAMENTE
PËR PROJEKTLIGJIN “PËR PROFESIONIN E AVOKATIT NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË”

Drejtuar : **Zotit GRAMOZ RUÇI**
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Bazuar në nenin 75, pika 4, të Rregullores së Kuvendit, paraqesim amendamentet mbi ndryshimet e propozuara nga Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike, si më poshtë:

1. Në nenin 15 të projektligjit “Organizimi i avokatëve”, në variantin e riformuluar nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut pika 4 të ndryshohet me këtë përmbajtje:

“4. Ndalohet krijimi i studiove të avokatisë, pa pjesëmarrjen e të paktën një avokati të pajisur me licencën profesionale të avokatit”

2. Në nenin 16 të projektligjit “Mënyrat e shpërblimit të avokatit”, në variantin e riformuluar nga Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike, shkronja ‘c’ e pikës 1 të ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“c) me udhëzim të përbashkët ndërmjet Ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për financat, pasi të kenë marrë më parë mendimin e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, në rastin e mbrojtjes së detyrueshme sipas Kodit të Procedurës Penale;”.

Ky ndryshim propozohet me qëllim harmonizimin e dispozitës me parashikimet e ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” për avokatët që ofronjë ndihmë juridike dytësore me ato që ofrojnë mbrojtje të detyrueshme.

DEPUTETËT PROPOZUES

Arben Bellumzi 
Edmond Lekaj 